

Vendim nr. 136 datë 21.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 21.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ARITON KASAJ, HELIDON GJIKOKA, ADISELDO RRAPAJ, ARDIAN MUSTA, DENIS METAJ, ERDET MANDI, ARBËR JAUPAJ, MIMOZA RRUSHANI, KRUPSKAJA GJIKA, ANDI HAXHIAJ, ERMAL MAHILAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 147, datë 12.07.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2023-469 (8), datë 16.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Lënia në fuqi e vendimit nr. 1282, datë 03.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
Pezullimi i gjykimit të çështjes penale nr. 1282 të regjistrit themeltar, datë 03.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

BAZA LIGJORE: Nenet 29, 30, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe

funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,
të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi I.K. ka pretenduar se me vendimin nr. 69, datë 16.02.2010, të KRRT-së pranë Bashkisë Himarë i është dhënë leja e ndërtimit për një kompleks banesash 1-2-katëshe, të cilat do të ndërtoheshin në tokën e tij dhe të vëllait të tij. Pas përfundimit të këtij kompleksi banesash, grupi i punës i ngarkuar me verifikimin dhe kolaudimin ka konstatuar se këto objekte nuk përputheshin me planimetritë e dorëzuara për marrjen e lejes së ndërtimit. Për këtë shkak shtetasi I.K. ka caktuar si përfaqësues të tij njërin prej kërkuesve, shtetasin Helidon Gjikota të ndjekë punimet, duke e pajisur edhe me dokumentacionin e nevojshëm në emrin e tij. Pasi është interesuar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Vlorë, shtetasi I.K. ka mësuar faktin se të gjitha objektet ishin regjistruar në emër të kërkuesit Helidon Gjikota, me anë të lejes së legalizimit nr. 211988, datë 20.09.2018.

2. Për sa më lart, shtetasi I.K. ka paraqitur dy kallëzime penale, për të njëjtin fakt penal, njërin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe tjetrin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Prokurori pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. 1600, datë 23.09.2019, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, të parashikuara nga nenet 186, 248 dhe 301, të Kodit Penal (KP). Në përfundim të hetimeve paraprake prokurori ka paraqitur në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe dërgimin në gjyq të saj për dy akuzat e tjera në ngarkim të kërkuesve Helidon Gjikota, Ariton Kasaj, Adiseldo Rrapaj, Ardian Musta, Ermal Mahilaj, Andi Haxhiaj, Krupskaja Gjika, Mimoza Rushani. Ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 5670, datë 10.09.2020 dhe në përfundim të hetimeve paraprake

ka paraqitur në gjykatë çështjen penale në ngarkim të kërkuessve Helidon Gjikota, Ariton Kasaj, Adiseldo Rrapaj, Ardian Musta, Denis Metaj, Erdet Mandi, Arbër Jaupaj dhe shtetaseve E. B. dhe J. H., sipas akuzave përkatëse. Gjyqtari i seancës paraprahe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur dërgimin e akteve gjykatës kompetente, asaj të rrethit gjyqësor Vlorë, e cila ka regjistruar çështjen në datën 08.07.2021. Me vendimin nr.10, datë 22.09.2021 të gjyqtarit të seancës paraprahe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur bashkimi i çështjeve penale.

3. Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë (gjyqtari i seancës paraprahe), me vendimin nr. 1282, datë 03.03.2022, ka vendosur: *“Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 5670/2020. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurve Helidon Gjikota dhe Ariton Kasaj për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”; Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit Ariton Kasaj, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i vulave dhe Stampave ose i formularëve”, e kryer në bashkëpunim. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit Adiseldo Arapaj, Ardian Musta, E. B., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, kryer në bashkëpunim. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurës J. H., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimit të detyrës”. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurve Denis Metaj, Erdet Mandi dhe Arbër Jaupaj të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Pavlefshmërinë absolute të vendimit, datë 07.04.2021 “Për sekuestrimin e sendeve” në lidhje me sekuestrimin (bllokimin) e objektit kompleks shërbimi me adresë: Gjilekë, Bashkia Himarë, zona kadastrale 1739, nr. Pasurie 300/301, sip. e parcelës ndërtimore 1353 m² sip. totale e ndërtimit 451 m² me pasojë shfuqizimin e tij. Urdhërohet dërgimi i këtij vendimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit topografik të kryer gjatë hetimit paraparak. Kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe detyrimin e saj për plotësimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. 5670/2020, sipas pjesës arsyetuese të vendimit. Veprimet hetimore të kryhen brenda 120 ditëve, duke filluar ky afat pasi vendimi të marrë formë të prerë. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet drejtuesit të prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 1600 viti 2019 për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimit të detyrës”. Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë*

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 1600 viti 2019. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurve Ardian Musta, Adiseldo Rrapaj, Mimoza Rushani, Krupskaja Gjika të akuzuar për kryerjen e veprës penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" në bashkëpunim. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurve Andi Haxhiaj, Ermal Mahilaj të akuzuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve". Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit Ariton Kasaj dhe të akuzuar për kryerjen e veprës penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" në bashkëpunim dhe "Falsifikimi i dokumenteve". Kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe detyrimin e saj për plotësimin e hetimeve në lidhje me procedimit penal nr. 1600 viti 2019, sipas pjesës arsyetuese të vendimit. Veprimet hetimore të kryhen brenda 120 ditëve, duke filluar ky afat pasi vendimi të marrë formë të prerë.”.

4. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kallëzuesi I.K., si dhe apel kundërshtues, kërkuarit Helidon Gjikota dhe Ariton Kasaj dhe shtetasit E. B. dhe J. H., si dhe apel kundërshtues më vete kërkuarit Ardian Musta dhe Adiseldo Rrapaj.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 147, datë, 12.07.2022, ka vendosur: ”Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për pushimin e procedimit penal nr.160, të vitit 2019, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” për të pandehurit Adiseldo Rrapaj dhe Ardian Musta, si dhe për disponimin mbi pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit topografik të kryer gjatë hetimeve paraprake. Ndryshimin e vendimit të mësipërm për pjesën tjetër, në këtë mënyrë: Pranimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, në kuadër të procedimit penal nr.5670/2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në ngarkim të të pandehurve: 1. Helidon Gjikota, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Mashttrimit" me pasoja të rënda e kryer në bashkëpunim dhe “Falsifikimi i vulave dhe stampave ose i formularëve e kryer në bashkëpunim”; 2. Ariton Kasaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi me pasoja të rënda e kryer në bashkëpunim” dhe “Falsifikimi i vulave dhe stampave ose i formularëve e kryer në bashkëpunim”; 3. Adiseldo Rrapaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës i kryer në bashkëpunim”; 4. Ardian Musta, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” i kryer në bashkëpunim; 5. E. B., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”; 6. J. H., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”; 7. Denis Metaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimi i dokumenteve” i kryer në bashkëpunim; 8. Erdet Mandi

akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve i kryer në bashkëpunim”; 9. Arbër Jaupaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve i kryer në bashkëpunim”. Pranimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq në kuadër të procedimit penal nr. 1600/2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në ngarkim të të pandehurve: 1. Ardian Musta, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", të kryer në bashkëpunim; 2. Adiseldo Rrapaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", të kryer në bashkëpunim; 3. Mimoza Rushani, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", të kryer në bashkëpunim; 4. Krupskaja Gjika, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", të kryer në bashkëpunim; 5. Andi Haxhiaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve"; 6. Ermal Mahilaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve"; 7. Ariton Kasaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim dhe "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", të kryer në bashkëpunim; 8. Helidon Gjikota, akuzuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim. Shfuqizimin e vendimit të mësipërm për: Deklarimin të pavlefshëm të vendimit datë 07.04.2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për sekuestrimin e objektit kompleks shërbimi në Gjilekë Bashkia Himare, zk.1739, nr. pasurie 200/301, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 1353 m2.”.

6. Kundër këtij vendimi, në datën 30.08.2022, kanë paraqitur rekurs kërkuetit Helidon Gjikota, Ariton Kasaj; në datën 01.09.2022, kërkuetit Adiseldo Rrapaj, Ardian Musta, Denis Metaj, Erdet Mandi, Arbër Jaupaj, Mimoza Rushani, Krupskaja Gjika, Andi Haxhiaj, Ermal Mahilaj; në datën 19.09.2022, shtetaset E. B. dhe J. H., si dhe po në këtë datë edhe kallëzuesi I.K., i cili ka kërkuar mospranimin e rekurseve të paraqitura, pasi vendimi i gjykatës së apelit, është një vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankimi.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-469 (8), datë 16.01.2023 ka vendosur: “Mospranimin e rekurseve të paraqitura nga kërkuetit Helidon Gjikota, Ariton Kasaj, Ardian Musta, Adiseldo Rrapaj, Erdet Mandi, Arbër Jaupaj, Denis Metaj, Andi Haxhiaj, Ermal Mahilaj, Mimoza Rushanji, Krupskaja Gjika, E. B. dhe J. H., kundër vendimit nr. 293, datë 12.07.2022 të Gjykatës së Apelit, Vlorë”, me argumentin se vendimi i gjykatës së apelit, i cili ka disponuar për dërgimin e çështjes në gjyq, bazuar në nenin 332/gj të Kodit të Procedurës Penale

(KPP) nuk mund të ankimohej, për rrjedhojë kundër tij nuk mund të bëhet rekurs, sipas nenit 432 të KPP-së.

8. Në datën 20.04.2023 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesve

9. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

9.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës së ankimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekursin e kërkuesve, me arsyetimin se kundër vendimit për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të tyre nuk lejohet ankim bazuar në nenin 332/gj të KPP-së. Kjo gjykatë duhet të kishte pezulluar gjykimin dhe bazuar në nenin 145 të Kushtetutës duhet ta kishte dërguar çështjen në Gjykatë, pasi ky nen i KPP-së cenon të drejtën e ankimit efektiv të individit, është në shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe vendos palët në pozita të pabarabarta, në kushtet kur legjislacioni ka parashikuar të drejtën e ankimit për vendimin e pushimit të çështjes penale, duke cenuar kështu edhe parimin e barazisë përpara ligjit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës.

9.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, megjithëse gjyqtari relator L. F. në gjykatën e apelit është caktuar me short, në vijim, një ditë më pas, kryetarja e kësaj gjykate e ka ndryshuar atë, me arsyetimin se ka pengesë ligjore për gjykimin e çështjes, pasi ai është shprehur me vendim të mëparshëm. Nga dosja rezulton se ky gjyqtar nuk ka bërë kërkesë për heqjen dorë dhe as palët në gjykim nuk kanë kërkuar përjashtimin e tij. Gjithashtu, kryetarja e gjykatës së apelit ka përjashtuar nga shorti edhe një gjyqtare tjetër pa shkak ligjor, duke vendosur në këtë mënyrë gjykimin e çështjes nga vetë ajo, në kundërshtim me

parashikimet ligjore. Kjo e drejtë është cenuar edhe në drejtim të faktit se gjykata e apelit në vendimmarrjen e saj ka dalë jashtë kompetencave të përcaktuara me ligj, duke shqyrtuar vendimin e gjyqtarit të shkallës së parë me të cilin është kthyer procedimi penal për plotësimin e hetimeve dhe dërgimin e çështjes në gjyq. Kjo gjykatë ka pasur kompetencë të shqyrtonte vetëm vendimin për pushimin e akuzave, por në asnjë rast vendimin për plotësimin e hetimeve.

- 9.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtarja I.B. e ka nxjerrë për gjykim çështjen në të njëjtën ditë (12.07.2022) që për të është kërkuar përjashtimi nga ana e kallëzuesit I.K. dhe vetëm 14 ditë pas regjistrimit të ankimit të datës 27.06.2022. Po kështu, kjo gjyqtare ka në gjykim një çështje të së njëjtës natyrë, ku palët janë në pozita të kundërta, përkatësisht kërkuesi Helidon Gjikota është kallëzues dhe e pandehur është A.K., e afërmja e shtetasit I.K. Rezulton se kjo çështje është shqyrtuar në datën 29.09.2022. Gjyqtarja I.B. e ka gjykuar çështjen nën presion, çka vërtetohet nga shkrimet mediatike për konfliktin e pronësisë midis palëve, si dhe fakti se në vendim ajo është shprehur tej kufijve të shqyrtimit dhe vlerësimit të gjyqtarit të seancës paraprake.
- 9.1.4. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë objekt gjykimi bie në kundërshtim me një vendim të saj të mëparshëm, të karakterit njësoj, vendimin nr. 00-2021-1134 (62), datë 01.11.2021. Ky parim është cenuar edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila ka disponuar në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit të drejtën për të paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të pushimit të akuzës e ka vetëm personi i dëmtuar nga vepra penale. Në rastin konkret, kallëzuesi I.K. nuk është viktimë, pasi gjatë hetimeve nuk është provuar se ai është pronar i pasurisë objekt konflikti. Pavarësisht se leja e ndërtimit është nxjerrë në emër të I.K., të gjitha objektet e legalizuara janë ndërtuar nga kërkuesi Helidon Gjikota, si dhe sipërfaqja e tokës ka qenë në pronësi të shtetit. Për rrjedhojë, mosmarrëveshja është e karakterit civil dhe jo penal.
- 9.1.5. *Së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Apelit Vlorë e ka gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit, pa

praninë e palëve, në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit procedural penal dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 15.02.2001. Kjo gjykatë nuk ka arsyetuar bazën ligjore, e cila parashikon të drejtën për shqyrtim në dhomën e këshillimit, por u referohet vetëm neneve 329, paragrafi 8 dhe 329/ç të KPP-së, të cilat nuk kanë lidhje me çështjen. Këto të drejta janë cenuar edhe nga Gjykata e Lartë me vendimin objekt kundërshtimi, pasi kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të rekursit, të cilat kishin të bënin me cenimin e të drejtave kushtetuese, por është kufizuar në faktin e moslejimit të ankimit.

9.1.6. *Standardit të arsytimit*, pasi argumentet e Gjykatës së Apelit Vlorë bien në kundërshtim me nenin 274 të KPP-së, sipas të cilit gjykata kompetente vendos sekuestrimin me kërkesën e prokurorit. Në rastin konkret, gjykata e apelit arsyeton se sipas këtij neni sekuestro preventive caktohet nga prokurori pa iu drejtuar gjykatës. Pjesa urdhëruese e këtij vendimi nuk ka lidhje me pjesën arsyetuese, pasi sekuestro preventive është vendosur kryesisht nga gjykata e apelit pa kërkesën e prokurorit. Ky standard është cenuar edhe nga vendimi i Gjykatës së Lartë, e cila nuk ka arsyetuar për pretendimin e kërkuarit Helidon Gjikota për gjykatën që ka marrë vendimin dhe kompetencat e saj lëndore.

9.2. *Të drejtën e pronës*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka riparuar shkeljet e Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur masën e sigurimit “Sekuestro preventive” ndaj pasurisë së kërkuarit Helidon Gjikota pa kërkesën e prokurorisë. Ky vendim bie në kundërshtim me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka bërë dallimin midis sekuestros provuese dhe preventive. Në këtë mënyrë këtij kërkuari i është cenuar e drejta për të gëzuar pronën e tij në mënyrë të qetë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarve

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja

“i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

12. Kolegji vëren se kërkuuesit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, për rrjedhojë, si bartës të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të pretenduar të cenuar, provojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë.

13. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata në jurisprudencën e saj në fushën penale ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, siç janë ato për caktimin ose zëvendësimin e masave të sigurimit personal, ose edhe ato për konfiskimin e pasurisë gjatë procedimit penal, për shkak të natyrës së këtyre vendimeve dhe pasojave që sjellin në të drejtat themelore të individit. Në rastin e pretendimeve ndaj vendimeve gjyqësore për masat e sigurimit (caktimin ose zëvendësimin e tyre), të cilat janë vendime që jepen në procedura të veçanta në funksion të procedimit penal të themelit, Gjykata ka vlerësuar se ato bëjnë pjesë *ratione materiae* në juridiksionin e saj. Në rastet kur kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit për masën e sigurimit penal “Arresti në burg” dhe ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë për këtë masë, është vlerësuar se ky lloj vendimi gjyqësor konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (shih vendimet nr. 19 datë 04.04.2023; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Kolegji vëren se në kërkesën e tyre drejtuar Gjykatës, kërkuesit kanë pretenduar se vendimet objekt kërkesë janë përfundimtare, pasi, si pasojë e tyre, janë cenuar të drejtat e tyre. Ato janë ankimuar në të tria shkallët e gjyqimit, si dhe vendimi i dërgimit në gjyq ka një masë autonomie nga procesi i themelit, pasi ky i fundit nuk mund ta ndryshojë vendimin e dërgimit në gjyq dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë.

16. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të tyre kundër vendimit të gjykatës së apelit, i cili ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke pranuar kërkesën e prokurorit për dërgimin në gjyq të çështjes në kuadër të procedimeve penale nr. 5670/2020 dhe nr. 1600/2019. Sipas ligjit procedural penal (neni 332/dh, pika 1, i KPP-së), pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata (gjyqtari i seancës paraprake) vendos: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës. Gjithashtu, sipas pikës 3 të këtij neni, procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykon vendimin përfundimtar të saj. Në këtë mënyrë, KPP-ja e ka përcaktuar vendimin gjyqësor të seancës paraprake, si aktin që fillon gjykimin dhe ky i fundit ka në objektin e tij përcaktimin e saktë të akuzës me vendimin përfundimtar të themelit.

17. Në analizë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të mësipërme, në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuesit, Kolegji çmon se vendimi i gjykatës së apelit që ka disponuar për dërgimin

në gjyq të çështjes në ngarkim të kërkuessve, për të cilin Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre, nuk mund të konsiderohet një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi jo vetëm që nuk vendos në mënyrë përfundimtare për fajësinë ose pafajësinë për kryerjen e veprave penale, për të cilat ata akuzohen, por as nuk është provuar se ka ndonjë efekt të tillë cenues në të drejtat themelore të kërkuessve, të cilat nuk mund të mbrohen gjatë gjykimit në themel të çështjes. Për rrjedhojë, ata i kanë të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre gjatë shqyrtimit të themelit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

18. Po kështu, për sa i përket kërkesës për pezullimin e gjykimit të çështjes penale nr. 1282 të regjistrimit themeltar, datë 03.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Kolegji konstaton se neni 45, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se kërkesa për pezullimin e aktit vendoset nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose nga Gjykata në seancë plenare, pra kur vlerësohet se çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë. Në kushtet kur çështja konkrete nuk plotëson kriteret paraprake për t’u shqyrtuar në seancë, Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullimin e gjykimit të çështjes nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.